

VENDIM
Nr. 95, datë 9.5.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 9, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608 prot., datë 27.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., me shkresën nr. 16 prot., datë 9.2.2022, protokolluar në ERE me nr. 257 prot., datë 11.2.2022, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie.

- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit të sjellë nga shoqëria, rezultoi se dokumentacioni nuk ishte i plotë, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresat e datës 23.2.2022 dhe në vijim me shkresën e datës 30.3.2022, duke i evidentuar dokumentacionin e paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në vijim, me shkresat e depozituara në ERE të datës 8.3.2022 dhe të datës 13.4.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion në kuadër të aplikimit të saj.

- Shoqëria duhet të plotësojë dokumentacionin që lidhet me kërkesat e nenit 7, pika 1, germet “e” dhe “f”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 235, datë 26.11.2021, që kanë të bëjnë me përshkrimin e kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe dokumentimin e kontributit financiar të tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

- Për sa përcaktuar në nenin 9, pika 2, të rregullores sipërcituar, shoqëria duhet të depozitojë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e këtij vendimi, dokumentacionin respektiv.

Për gjithë sa më sipër, Bordin i ERE-s

VENDOSI:

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin plotësues, në lidhje me përshkrimin e kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe kontributit financiar të tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti